

Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetit

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	3
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	5
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Menaxhimi i cilësisë	6
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikëria.....	8
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	9
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Spektori i Statistikave të Mjedisit dhe Pyjeve, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
1.3. Personi i kontaktit	Benard Shalca
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në Sektorin e Statistikave të Mjedisit dhe Pyjeve
1.5. Adresa postare	Rruga Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	bshalca@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Certifikimi i fundit i metadatës	09.09.2026
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	09.09.2026
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	09.09.2026
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetin sigurojnë të dhëna të përgjithshme dhe specifike mbi prodhimin e lëndës drusore dhe asortimentet kryesore, shfrytëzimin e produkteve nga pyjet si dhe të dhëna mbi bilancin kadastral të fondit pyjor. Të dhënat për kullotat ofrojnë informacion për pronësinë, madhësisë dhe kohën e shfrytëzimit të tyre sipas stinëve. Të dhëna për biodiversitetin japin informacion për zonat e mbrojtura sipas kategorive, specieve të kërcënuara dhe të mbrojtura, për florën dhe faunën.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Nuk aplikohet.
3.3. Mbulimi i sektorit	Statistikat e pyjeve mbulojnë të dhëna të përgjithshme dhe specifike mbi prodhimin e lëndës drusore dhe asortimentet kryesore, shfrytëzimin e produkteve

	nga pyjet si dhe të dhëna mbi bilancin kadastral të fondit pyjor në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Kadastra e pyjeve është një dokument zyrtar (regjistër), ku evidentohen, pasqyrohen, mbahen e përditësohen të dhënat fillestare për çdo njësi të ekonomisë pyjore apo për pëllgjet ujëmbledhëse, të dhënat për ndryshimet periodike në vëllime, sipërfaqet dhe hartat përkatëse. Fond pyjor janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura përkatëse, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura, të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e tokën pyjore (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtat), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurret. Fondet kullosore janë të gjitha sipërfaqet e kullotave dhe livadheve natyrorë, drurët e shkurret brenda sipërfaqeve të tyre që përdoren për kullotje jashtë fondit të tokës bujqësore. Zona të mbrojtura shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore. Zonat e mbrojtura ndahen në 6 kategori të cilat janë: Rezervë Strikte Natyrore, Park kombëtar, Monument natyror, Rezervat natyror i menaxhuar, Peisazhi i mbrojtur, Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e Statistikave të Pyjeve janë: Institucione Publike
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore i referohet: pyjeve, kullatave, import-eksportin e lëndës drusore dhe biodiversitetit.
3.7. Zona e referencës	Statistikat e Pyjeve mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat statistikore për “Investime të realizuara në pyje” datojnë në vitin 1998 dhe në vazhdim. Të dhënat për “Bilancin kadastral të fondit pyjor dhe kullosor të Shqipërisë” datojnë në vitin 2006. “Fondi kullosor sipas pronësisë dhe stinëve të shfrytëzimit” dhe “Lënda drusore e eksportuar/importuar” datojnë në vitin 2012, etj.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Njësia matëse e përdorur është Sip/ha, m ³ dhe Lekë.

5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Periudha referuese e informacionit statistikor mbi Statistikat e Pyjeve është vjetore. Ky raport i përket vitit referencë 2025.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore në nivel kombëtar në të cilin bazohen treguesit e Statistikave të Pyjeve dhe Biodiversitetit janë: • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026 • Memorandumet e bashkëpunimit të hartuara me Ministrinë e Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Baza ligjore në nivel Evropian: • Marrëveshja e Grupit Punues Ndër-Sekretariat (IWG) të vitit 1990 për statistikën e pyjeve, për Pyetsorin e përgjithshëm të pyjeve (JFSQ). Grupi përbëhet nga përfaqësues të Eurostat, UNECE, FAO dhe ITTO.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Pyjeve transmetohen në EUROSTAT, nëpërmjet Pyetsorit të përgjithshëm të pyjeve (JFSQ).
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti-politika	Të dhënat konsiderohen konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 Për Statistikat Zyrtare , si dhe Ligjin Nr. 124/2024, "Mbrojtja e të Dhënave Personale" . Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti-trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk u shpërndan palëve të treta të dhënat e mbledhura nga, apo tek të cilat ka akses, të dhëna këto që mund të shërbejnë në identifikimin drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të njësive statistikore që i kanë ofruar të dhënat në fjalë për arsye dhe qëllime statistikore, apo të dhëna të vjela nga burime të tjera administrative. INSTAT ndërmerr tërë masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të

	mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i statistikave vetëm në rast se: - këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; - njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave. Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i Institutit të Statistikave. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërdahet dhe të bëhet publike nga Instituti i Statistikave, me qëllim që të bëhet i pamundur identifikimi i njësisë statistikore nga këto të dhëna; kriteret e anonimizimit për të dhënat mikro që u ofrohen përdoruesve; dhënia e aksesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	Kalendari i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: Faqeweb – publikim në internet; - Kërkesat e shkruara; - Publikimet e Statistikave të Pyjeve dhe Biodiversitetit; Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetit shpërndahen me frekuencë vjetore.

10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të statistikave të pyjeve. Njoftimi për shtyp për statistikat e pyjeve publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet për Statistikat e Pyjeve gjenden të botuara nën temat: Statistikat e Pyjeve , Vjetari Statistikor dhe Shqipëria në shifra .
10.3. Baza e të dhënave online	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Të dhënat e Statistikave të Pyjeve mund të gjenden në format Excel ku treguesit kryesorë jepen të detajuar. Baza e të dhënave përmes sistemit Pc-Axis mund të aksesohet edhe në linkun: databaza statistikore .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat mbi Statistikat e Pyjeve janë të dhëna administrative dhe si të tilla janë të disponueshme vetëm në nivel të agreguar. Pra, INSTAT nuk disponon të dhëna në nivel mikro për Statistikat e Pyjeve.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodogjinë e përdorur mbi Statistikat e Pyjeve.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Mjedisit dhe Pyjeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e Statistikave të Pyjeve dhe Biodiversitetit për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” , INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuar. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve

	dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat për Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetin krahasohen me të dhënat e mbledhura me vitet e mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e Statistikave të Pyjeve ndahen në përdorues të brendshëm dhe të përdorues të jashtëm. Përdorues të jashtëm: • Institucione të administratës publike; • Universitetet; • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Bizneset; • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. Përdorues të brendshëm janë të gjithë ata sektorë që përdorin Statistikat e Pyjeve si input në punën e tyre.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vërtetimin për Matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve, rezultatet e të cilit publikohen në web në linkun: Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve .
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave për “Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetin” për vitin 2025 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare (2022-2026). Shkalla e plotshmërisë së të dhënave, për Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetin, është 100%.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton burimet përkatëse të të dhënave për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.

13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.								
14. Afatet kohore dhe përpikëria									
14.1. Afatet kohore	Rezultatet për “Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetit” publikohen 252 ditë pas periudhës referuese (T+252 ditë). Periudha referuese e rezultateve mbi Pyjet dhe Biodiversitetin është 31 Dhjetor 2025. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2025</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>9/9/2026</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>252</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2025	Data e publikimit	9/9/2026	Afatet kohore	252		
Periudha referuese	12/31/2025								
Data e publikimit	9/9/2026								
Afatet kohore	252								
14.2. Përpikëria	Të dhënat mbi Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetit publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave të Pyjeve dhe Biodiversitetit, ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2025</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>9/9/2026</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>9/9/2026</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2025	Data e shpallur	9/9/2026	Data e publikimit	9/9/2026	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2025								
Data e shpallur	9/9/2026								
Data e publikimit	9/9/2026								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahaseshmëria									
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Të dhënat mbi Statistikat e Pyjeve janë gjithëpërfshirëse, ato prodhohen në nivel vendi. Këto statistika janë të krahaseshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.								
15.2. Krahaseshmëria kohore	Informacioni statistikor mbi treguesit e “Fondit pyjor sipas llojeve”, “Fondi kullosor sipas pronësisë dhe stinëve të shfrytëzimit” dhe “Lënda drusore e eksportuar/importuar” grumbullohet në të njëjtën mënyrë duke datuar nga viti 2012, duke siguruar një krahaseshmeri kohore prej 14 vitesh ($CC2=J_{last}-J_{first}+1=14$). Informacioni statistikor mbi treguesit “Të ardhura nga aktivitete dytësore në pyje dhe kullota” dhe “Të dhënat për bilancin kadastral të fondit pyjor dhe kullosor të Shqipërisë” grumbullohet në të njëjtën mënyrë duke datuar nga viti 2006, duke siguruar një krahaseshmeri kohore prej 20 vitesh ($CC2=J_{last}-J_{first}+1=20$). Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahaseshmërinë e tyre në seri kohore.								

15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohet përpara se të finalizohet. Kontrollohen lidhjet ndërmjet variablave dhe konfirmohet koherenca midis serive të brendshme të të dhënave të ndryshme.
16. Kostoja dhe ngarkesa	
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave të pyjeve pranë Sektorit të Statistikave të Mjedisit dhe Pyjeve është: 1 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT, pasi të dhënat e statistikave të pyjeve sigurohen nga burime administrative, konkretisht nga Ministria e Mjedisit.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të Statistikave të Pyjeve bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: • Politika e Revizionimit Statistikor; • Politika e Trajtimit të Gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast se burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetit do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit. Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetit” për vitin 2025, subjekt i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetin mbështeten në informacionin administrativ, të siguruar nga Ministria e Mjedisit dhe institucione të tjera përgjegjëse në varësi të saj si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Pyjeve, me vlerësim ekspertesh. Institucioni përgjegjës për të grumbulluar këto të dhëna është Ministria e Mjedisit dhe institucione të tjera përgjegjëse në varësi të saj si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Pyjeve, sipas vkm Nr. 433, Datë 8.6.2016 për Transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, informacioni mblidhet në të gjitha bashkitë e vendit të cilat kanë detyrimin ligjor të raportojnë çdo tre muaj në Ministrinë e Mjedisit.

18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat e Statistikave të Pyjeve dhe Biodiversitetit mblidhen në bazë vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave të Pyjeve për vitin 2025, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Ministria e Mjedisit është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij program.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike. Këto kontrolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	